



BASHKIA  
TIRANË

**R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë**  
**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE**

[Dt. 08.07.2022]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**OPERATORIT EKONOMIK “SOFT & SOLUTION” SHPK**

**Adresa:** Tirane Rruga: "Tefta Tashko", Pazari i Ri, Nr. 185, Njesia Administrative Nr. 2.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [*Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës*] **”Sistemi i ndjekjes dhe arkivimit të çështjeve drejtuar Policisë Bashkiake” me Nr. reference REF-31318-05-31-2022** për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini Nr. 72 datë 6 Qershor 2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- **Operatori ekonomik “SOFT & SOLUTION” sh.p.k, NIPT L11328009F**

Vlera e ofertës pa tvsh = 13,577,777 (trembëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

2. **Operatori Ekonomik “FASTECH” sh.p.k, NIPT J81609010U**

Vlera e ofertës pa TVSH– 13,789,984 (trembëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lekë

Nga pjesërmarrësit është s'kualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik "FASTECH" sh.p.k, NIPT J81609010U**

Për arsyet e mëposhtme:

- I. Autoriteti Kontraktor, referuar Shtojcës 2 "Lista e Cmimeve të Shërbimeve" (shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik), pjesë e Dokumenteve Standarte të Tenderit për këtë procedurë objekt vlerësimi citon:

.. "Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **13.933.400 (trembëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind)** lekë pa tvsh, i përbërë nga dy vlera që u përkasin dy llogarive të ndryshme, respektivisht llogarisë për investime dhe asaj për shpenzime korrente, si më poshtë vijon:

1. **"Sistemi i ndjekjes dhe arkivimit të çështjeve drejtuar Policisë Bashkiake"**, në programin buxhetor "Investim (231)" me tipologji **"Software"** me vlerë të fondit limit **11.866.700 (njëmbëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind)** lekë pa tvsh.
2. **"Sistemi i ndjekjes dhe arkivimit të çështjeve drejtuar Policisë Bashkiake"**, në programin buxhetor "Shpenzime operative (602)" me tipologji **"mirëmbajtje +trajnim"** me vlerë të fondit limit **2.066.700 (dy milion e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind)** lekë pa tvsh.

**Shënim: Referuar rekomandimit nr. 6911 prot., datë 28.10.2020 të APP-së, vlerat e ofertës ekonomike të investimit dhe të mirëmbajtjes të ofruara nga operatorët ekonomikë nuk duhet të tejkalojnë vlerën e fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës për këto zëra, pasi në të kundërt oferta do të konsiderohet si ofertë e dhënë mbi fond limit dhe si e tillë, nuk mund të kualifikohet."**

Referuar tabelës "Lista e cmimeve" pjesë e Shtojcës 2 "Lista e cmimeve të shërbimeve" e DST, paraqitur në spe nga operatori ekonomik "FASTECH" SH.P.K, vlera respektive e artikullit 1 tejkalon vlerën e fondit limit të përcaktuar nga AK për këtë zë, konkretisht:

1. Sistemi i ndjekjes dhe arkivimit të çështjeve drejtuar Policisë Bashkiake (faza përgatitore, zhvillim sistemi, testim, instalim, marrja në dorëzim) është **11.870.000 (njëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë)** lekë pa TVSH.

Referuar sa më sipër, Operatori ekonomik "FASTECH" SH.P.K nuk i është përmbajtur kushteve të AK për këtë procedurë prokurimi duke mos respektuar ndarjen e vlerave të zërave të Shtojcës 2 "Lista e cmimeve të shërbimeve" respektivisht sipas programeve buxhetore "Investim (231)" dhe "Shpenzime operative (602)" të AK.

Sa më sipër, KVO konkludon se operatori ekonomik "FASTECH" sh.p.k, nuk ka përmbushur Shtojcën 2 "Lista e cmimeve të shërbimeve", pjesë e dokumentave standarte të tenderit, duke e

s'kualifikuar nga procedura e prokurimit me objekt “*Sistemi i ndjekjes dhe arkivimit të çështjeve drejtuar Policisë Bashkiake*”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**SOFT & SOLUTION**” SHPK, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 13,577,777 (trembëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferta e Suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.